ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: AGJENCIA PËR MENAGJIM EMERGJENT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**21432700-22-3555-1-1-1**
Nr i brendshëm	**214-22-05-111**

Sa i përket tenderit: ''Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajërit''.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

Fitim R. Bilalli BI
(Shëno emrin e plote te kompanisë suaj)

Rr. Shefqet Shkupi p.n.
(Adresa)

Prishtinë — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044242555 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Fitim Bilalli
(Emri i plote i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@dardanix.com
(Adresa elektronike)

16.11.2022

(Data e parashtrimit të ankesës) — ***(Nënshkrimi dhe vula)***

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 22.04.2022 Data e hapjes së ofertave: 03.06.2022 Njoftimi mbi vendimin e AK-së:10.11.2022 Kërkesa për rishqyrtim me dt:11.11.2022 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:14.11.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Vendimi i PSH. Nr.408/22 i dt.03.11.2022
Ekspertiza N.408/22 e dt. 19.09.2022.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 10.11.2022 përmes e-prokurimit jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së (Ri-vlerësim), ku është rekomanduar për kontratë OE "N.T.SH M.S.MEDICOM", ndërsa ne jemi shpallur si tenderues të eliminuar.

Pas rivlerësimit AK-ja na ka eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Katalogu i ofruar nga ana juaj dhe Mostra e ofruar nga ana juaj nuk plotëson kriteret e kerk Aneksin nr.1 tek ,, MASKA – Full Face Mask" komisioni profesional këtë e ka vërtet konstatuar edhe me anë te linkut **https://interspiro.com/en-gb/products/firefighting/face-r h-ambient-air-hatch** i deklaruar nga ana juaj ne deklaraten për link e prodhuesit Inters ashtu edhe me anëte Mostres

Oferta e juaj nuk ploteson specifkimin teknik sipas Aneksit nr.1 te DT-së për „ **MASKA – Full Face Mask**" në pikën më te rendesishme te saj si në vijim:

SPECIFIKIMI TEKNIK I KËRKUAR		SPECIFIKIMI TEKNIK I OPERATORIT EKONOMIK
MASKA – Full Face Mask		**S-H Ambient air Hatch**
Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes	P	Maska nuk posedon sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes sipas specifikimit e cila eshte e kerkuar "P" - Maska e prezantuar nga ana juaj ne ofertë - katalog dhe ne moster posedon tjeter lloj sistemi te lidhjes me aparatin e frymarrjes, ka sistemin - "M16" "M16" - është sistem i lidhjes me bulon dhe është ne kundershtim me qfar është kërkuar. "P"(Pluning)- është sistem i lidhjes se shpejt dhe i dyfisht i cili garanton lidhje te sigurta ne kushte te vështira (vendoset leht dhe sigurt) gjate çdo intervenimi te zjarrfikesit. *Shih foton e Maskes se prezantuar nga ana juaj ne Katalog dhe ne Moster qe tregojn se e njeta ka sistemin e lidhje „ M16" dhe jo "P":*

Fillimisht ju sqarojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, është nxjerr një **vendim nga paneli shqyrtues i OSHP-së nr.408-22 të dt.04.11.2022** e ku me këtë vendim është aprovuar ankesa jonë si pjesërisht e bazuar si dhe është detyruar AK-ja që të kthej lëndën në rivlerësim. Edhe pse gjatë procedurave të ankesës është sqaruar në detaje se ne jemi eliminuar pa bazë dhe pa arsye të qëndrueshme, AK-ja po vepron njëjtë duke na eliminuar neve me arsye të paqëndrueshme si dhe po rekomandon për kontratë një OE i cili është i pa përgjegjshëm.

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë si dhe pretendimi ynë ankimor në këtë rast është gjykuar, ku në vendimin e lartcekur të panelit shqyrtues të OSHP-së është vërtetuar fakti se ne kemi ofruar Maskën me të gjitha parametrat e kërkuara në FDT. Pra AK-ja është dashur të respektoj vendimin e OSHP-së, pasi që nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me arsyetime të njëjta të cilat janë shqyrtuar dhe është marr një vendim nga OSHP. Andaj duke u bazuar në këtë fakt arsyeja e AK-së për eliminimin tonë dhe pretendimi ynë faktikisht është çështje e gjykuar **(res judicata) sipas nenit 105 paragrafi 2.16 të LPP**-së, sepse për këtë çështje është vendosur me vendim meritor nga ana e OSHP-së, e ku **objekti i kontestit është i njëjtë dhe palët janë të njëjta.**

Në vendimin e OSHP-së me nr.408-22 sa i përket pretendimit tonë ankimor për arsyet eliminimit, është vërtetuar qe ne jemi eliminuar pa ndonjë bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Ky fakt është vërtetuar edhe me ekspertizë e ekspertit shqyrtues **Nr.408/22 të dt. 19.09.2022** ku i njëjti kishte konstatuar se:

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka eleminuar ofertën e OE anukues si te papërgjegjëshme për shkak të mos plotësimit të specifikimit teknik të dhënë në dosjen e tenderit. Mirëpo oferta e OE ankues ka plotësuar kushtet teknik të kërkuar në specifikim teknik nga AK. Oferta e OE ankues është ofertë e përgjegjëshme për pikat të cilat është eleminuar. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendëreve në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Ka eleminuar ofertën me çmim më të ulët dhe ka rekomanduar për kontratë ofertën e cila ka çmimin më të lartë për **79.756,00 €** se oferta e OE ankues. Pra rezulton që AK nuk ka respektuar edhe nenin 60 të LPP-së.

Duke u bazuar në ekspertizën e lëshuar nga eksperti shqyrtues, OSHP-ja ka vendosur si në vijim:

Paneli Shqyrtues pretendimin ankimor me nr.1 e klasifikon të bazuar dhe pretendimin me nr. 3 të OE ankues e klasifikon si të pabazuar dhe e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimit, i cili është caktuar nga OSHP.

Pra nga konstatimi i lartcekur i OSHP-së kuptohet qartë se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë në lidhje me Maskën e prezantuar nga ne është arsyetim i pa qëndrueshëm, pasi që një fakt i tillë është vërtetuar nga një organ i një shkalle më të lartë siç është OSHP-ja.

Andaj ne edhe një herë po ju sqarojmë se arsyeja e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë ku e ka cekur se: *"Maska nuk posedon sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes sipas specifikimit e cila është kërkuar "P", maska e ofruar nga ju posedon tjetër lloj sistemi të lidhjes, ka sistem "M16"* **<u>është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar</u>**.

Në lidhje me këtë çështje ne edhe një herë ju sqarojmë se pikërisht **OE i rekomanduar për kontratë në kërkesën për sqarime shtese të bërë më dt. 18.05.2022 ka parashtruar pyetje se a mund të ofrohet maskë pa kapësen e ajrit, pasi qe sipas këtij OE këtë pikë e plotëson vetëm një prodhues „Interspiro" (prodhuesi me të cilin kemi dorëzuar ne ofertë) me sqarimin se funksionin e kësaj kapëse mund ta përmbushin edhe prodhuesit tjerë duke liruar automatin e frymarrjes.**
Përgjigjja e AK-së ka qenë si në vijim *<u>"MASKA: Ka mundësi që të përdoren edhe sisteme të ngjashme dhe ekuivalente me ato të specifikuara ne dosje të tenderit te aneksi nr.1"</u>*, pra AK-ja ka lejuar që të ofertohet edhe me produkte që kanë sistem të ngjashëm dhe ekuivalent. Nisur nga kjo përgjigje që AK-ja e ka dhënë, ne kemi ofertuar dhe kemi ofruar maskën e cila është ekuivalente dhe e ngjashme M16 me specifikat e kërkuar në dosje të tenderit, si dhe **maska jonë për më tepër e ofron mundësinë e përdorimit të ajrit të ambientit sa herë që përdoruesi e aktivizon atë,** kurse maska e OE të rekomanduar për kontratë nuk e ofron këtë mundësi (arsyetimi është i dhënë më poshtë tek pretendimet tona për papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë) .

Gjithashtu ne deklaratën e ofruar nga prodhuesi ynë INTERSPIRO AB në lidhje me produktin e ofruar ceket se "*being a manufacturer of all items specified in this tender, can slightly adopt, modify, and adjust production according to customer needs, if required and agreed upon, to match customer satisfaction*", pra sqaron që produkti i ofruar është në përputhje të plotë me specifikacionet e dosjes së tenderit dhe kërkesave të FDT-së, gjithashtu **produkti mund të adaptohet ose të modifikohet nëse është e nevojshme dhe nëse kërkohet nga autoriteti kontraktues**. (Një fakt të tillë e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij nr.408/22 të dt.19.09.2022).
Lidhur me të gjitha faktet që i potencuam dhe ju sqaruam më lartë, u kuptua dhe u sqarua se eliminimi i ofertës tonë është bërë pa fakte dhe pa asnjë bazë ligjore, dhe nga këto sqarime kuptohet se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe se oferta jonë është në përputhje të plotë me kërkesat e FDT-së dhe dosjes së tenderit.

Gjithashtu me rastin e eliminimit tonë AK-ja nuk i ka marr parasysh konstatimet dhe e panelit shqyrtues të OSHP-së, të cekura në vendimin nr.408/22, prandaj **ky fakt përbën shkelje të qartë të procedurave ligjore dhe mosrespektim të vendimeve të një organi të shkallës më të lartë siç është OSHP-ja, pasi që dihet se vendimet e OSHP-së janë vendime obligative dhe përfundimtare.**

Poashtu, në lidhje me produktet e ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit, ju rikujtojmë se ne si OE kemi një kontratë të përfunduar me autoritetin kontraktues për aktivitetin e prokurimit të vitit 2020 për produkte të njëjta, e ku deri më tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje në lidhje me produktet që i kishim ofruar dhe ky fakt tregon më së miri se produktet tona të ofruar kanë qenë në rregull dhe në përputhje me kërkesat e AK-së.
I njëjti aktivitet kishte kaluar nëpër filtrat e ankesës duke përfshirë edhe OSHP, dhe njëri ndër pretendimet ishte githashtu për lidhjen "P" vs "M16", mirëpo në fund gjithashtu ishte konfirmuar se oferta jonë ishte e përgjegjshme (**shih Vendimin Nr.851/20 i dt.13.11.2020**)
Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me ofertën tonë atëherë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së edhe pse një gjë e tillë është e panevojshme fare, për shkak se përgjegjshmëria jonë është konstatuar nga eksperti shqyrtues dhe vërtetuar nga paneli shqyrtues i OSHP-së.

Ne edhe një herë ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE të pa përgjegjshëm e për të cilin do ti paraqesim faktet si më poshtë:

Tek specifikacionet teknike në Aneksin 1, Maska: është kërkuar *"Masa e maskës duhet të përbëhet nga dy shtresa izolimi të dyfishtë për të siguruar përshtatje të sigurt për të gjitha format e fytyrës", kurse OE* i rekomanduar për kontratë ka ofruar maskën e prodhuesit Drager model FPS7000 e që përbëhet nga 3 shtresa izolimi e cila ofrohet vetëm izolim i maskës për fytyrë, e jo edhe përshtatje të sigurt për formën e fytyrës, ashtu siç është kërkuar ne dosje të tenderit. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar maskën që nuk është në përputhje me specifikimet teknike të dosjes së tenderit dhe është i papërgjegjshëm.
Gjithashtu kërkesa tjetër të Maska ka qenë: *"Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në pritje"*, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar maskën e cila posedon kapëse të ajrit të ambientit që të mundëson përdorimin e ajrit të ambientit siç është kërkuar ne Specifikacionet teknike. E njëjta nuk e ka ofruar një sistem të ngjashëm ose ekuivalent, edhe përkundër faktit që AK-ja përmes sqarimeve shtese të dt.18.05.2022 ka lejuar sistem të ngjashëm dhe ekuivalent por që duhet obligativisht të ketë kapëse te ajrit të ambientit që të mundëson përdorimin e ajrit të ambientit.

OE i rekomanduar për kontratë gjithashtu nuk e ka plotësuar as kërkesën tjetër tek specifikacionet teknike, sa i përket Maskës e ku është kërkuar *"Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit"* sepse valvula e kapur me plug-in connector të cilën e ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë nuk garanton që të mos humbas gjatë operacionit dhe jeta e zjarrfikësit kësisoj mund të vihet në rrezik, kjo për faktin se nuk shtrëngohet. Valvula e ofertuar nga ne është e modelit M16 e cila pikërisht nuk lejon që të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit, ndërsa AK-ja në arsyetimin e tyre shkruan se sistemin e valvulës me lidhjen P e konsideron si lidhje "e shpejte" dhe "e sigurte". Ky konstatim është në kundërshtim me vet kërkesën e AK-së për të patur një valvulë të frymëmarrjes që të mos jetë e mundur të humbas gjate operacionit.

Se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, e dëshmon edhe fakti tjetër se te Specifikimet Teknike përkatësisht Sistemi Mbrojtës është kërkuar: *"Rripat e shpatullave duhet të janë të veshura me gome ose nga materiali zjarrdurues retardante dhe të janë*

rezistente ndaj gërryerjes dhe shpimit, te janë rezistente ndaj kimikateve dhe te janë rezistent ndaj zjarrit, të punuara me aramid", ndërsa OE i rekomanduar me kontratë në katalogun e ofruar - Katallogu dhe certifikatat për korniza bartëse PSS4000, rripat e shpatullave nuk i ka ofruar të jenë rezistente ndaj zjarrit, të punuara me aramid ose Kevlar. Rripat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë janë nga goma dhe rezistente ndaj grisjes, gërryerjes dhe përfshirjes së flakës, **por jo zjarrduruese siç kërkohet**. Pra, ka ofruar rripat e shpatullave rezistente ndaj përfshirjes se flakës por jo zjarrduruese. **Bashkangjitur keni fotot e këtij produkti si dhe vet përshkrimin e katalogut nga OE i rekomanduar për kontratë, që e dëshmojnë dhe e faktojnë këtë pretendim tonin ankimor.**

Arsyeja tjetër pse ky OE është i pa përgjegjshëm, është fakti se: Ne dokumentin e ofruar nga ky OE -Katalogun dhe certifikatat për korniza bartëse PSS4000.pdf, ka ofruar specifikimin teknik të kornizës bartëse "Modeli Drager PSS 4000", ndërsa sa i përket certifikatës se kërkuar (MED) 2014/90/EU, OE i rekomanduar për kontratë, në këtë dokument ka ofruar vetëm deklaratë nga vet prodhuesi Drager mbi konformitetin e pajisjeve (DECLARATION OF CONFORMITY) dhe jo Atest (certifikate) nga Laboratori i pavarur, siç kërkohet në Specifikimin teknik ***(Duhet të jetë i testuar sipas Direktivave (MED) 2014/90 / EU)***.
Po ashtu, në këtë dokument është përfshirë edhe një raport i kornizës bartëse "Modeli Drager PSS 4000" i lëshuar nga "Dekra" për standardin e kërkuar EN 137 (faqe 18-34), por sidoqoftë ky raport testues, nuk do të duhej të merret parasysh, **sepse i tëri është vetëm në gjuhë gjermane dhe jo në njërën nga gjuhet zyrtare të Republikës se Kosovës, prandaj ky fakt bie në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 13 të LPP-së ku shkruan** "*Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.*

Gjithashtu ky raport testimi është i pavlefshëm me që data e lëshimit të saj është 29 gusht 2008, ndërsa në po të njëjtën faqe shkruhet: Die Geltungsdauer der Bescheinigung betragt 5 Jahre ab dem Ausstelldatum, e që në përkthim i bie "Certifikata është e vlefshme për 5 vjet nga data e lëshimit". Pra ky atest është i pavlefshëm për tash e afër 9 viteve.

OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se, tek Specifikacionet teknike, cilindrin e ofertuar, **në tabelën e specifikimeve të ofertuara shkruan se pesha maksimale e cilindrit të ajrit është 2.8kg**, ndërsa në dokumentin tjetër te prezantuar - Katallogu dhe certifikatat për Cylinder CFK type 4 NANO, **shkruan që pesha e cilindrit të ngjyrosur është 3.1kg**, përderisa ne deklaratën e prodhuesit - Manufacturers Statement - Dräger PSS® 4000 shkruan qe pesha e cilindrit është 3.3 kg. Pra OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar të dhëna të sakta për sa i përket këtij artikulli dhe se të dhënat e prodhuesit nuk janë në përputhje me katalogun e as me deklaratën e specifikacioneve teknike, e që i bie se ky OE ka ofertuar me variante edhe pse në FDT nuk janë autorizuar variantet.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka dorëzuar katalogun dhe certifikatat për Cylinder CFK type 4 NANO, e ku në faqet e fundit të raportit (certifikatat e prodhuesit) mund të shihet se prodhues i cilindrit të ofertuar **nuk është Drager** siç paraqitet me ofertë, por është kompania Techplast LTD nga Polonia (http://techplast.net) me brendin e tyre SAFER e ku mund të verifikohet shumë lehtë me një kërkim në internet. https://safercylinders.net/en/all-products.
Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush as këtë kërkesë dhe ky fakt tregon që është i pa përgjegjshëm dhe si i tillë duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbush as kërkesën tek specifikimet teknike dhe profesionale, përkatësisht piken 9.1 & 9.2, ku kërkohet: "*Operatoret ekonomik duhen të*

dorëzojnë Autorizim nga prodhuesi ose përfaqësuesi - dileri i tij për shitje të paisjeve. Operatori Ekonomik duhet te dëshmoi se është i autorizuar nga prodhuesi - dileri i autorizuar i prodhuesit për shitjen e paisjeve me të cilat ofertojnë me titull dhe nr. Te Prokurimit të projektit në fjalë" sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar autorizimin nga prodhuesi Techplast LTD nga Polonia, e as nga SAFER, sipas kërkesës se FDT-të cilën e cituam më lartë.

Duke pasur parasysh të gjitha dëshmitë që i ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë, si dhe pretendimet tona ankimore që u dëshmuan më lartë me fakte konkrete, rezulton se ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, kurse oferta jonë është në përputhje të plotë më kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë si dhe jemi OE i përgjegjshëm me ofertën më të lirë, e **kur bëhet analiza e çmimeve në raport me OE e rekomanduar për kontratë rezulton se ne jemi me çmim më të lirë në shumën prej 79.756,00 eurove**.
Diferenca e çmimit, lirisht mund të përdoret në një aktivitet tjetër të prokurimit dhe të shfrytëzohet racionalisht buxhet e që do të ishte në dobi të qytetarëve.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne si OE i përgjegjshëm jemi diskriminuar haptas nga ana e AK-së në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë.

Me dt.14.11.2022 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja me arsyetimin se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

AK-ja në vendimin për refuzim i ka përsëritur arsyet e njëjta sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së, tani duke e zgjeruar edhe më shumë arsyen për eliminimin tonë.

E njëjta në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e cek se:

Pretendimi juaj ankimor se AK ka lëshuar përgjegjie sqaruese me **daten 18.05.2022** lidhur me konektimin e Maskës – P - **Nuk qëndor** pasi që kërkesa ne specifkimim teknik për Valvulën për pordorim te ajerit nga ambienti është tjetër kërkesë kurse nga ajo e **Sistemit te lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P tjetër. Këto** janë dy elmente te ndryshme te kërkuara ne specifikim teknik.

Autoriteti Kontraktues ne specifikim teknik tek Dosja e tenderti - tek MASK ka pasur kërkesën si vijon:

Madhesite	Min. 3 madhësi
Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një valvul të integruar të frymëmarrjes, të kyçur në maskën e fytyrës.Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit.Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në pritje.	

Për këtë kërkes ne specifkim teknik ka pasur kërkes për saqarim dhe atë me pyetjen si në vijim:

MASKA – A mundet që te ofrohët maska pa kapësen e ajërit, pasi që këtë pike e ploteson vetëm një prodhuess „Interspiro Air Hatch" funksionin e këapese munden qe ta plotesojn ehde prodhues te tjer duke liruar automatin e frymarrjes

Autoriteti kontraktues konform LPP dhe pyetjes sqaruese me daten 18.05.2022 ka lëshuar përgjegjein si në vijim:

MASKA – Ka mundesi që te pordoren edhe sisteme te ngjajshem dhe ekujvalente me te specifikuara ne DT- Aneksin nr.1. Ky sistem mundeson pordorimin e ajërit te ambientit saher qe pordoruesit e aktivizojn këtë.

E që ne këtë rast te përgjegjies AK ka pranuar çdo Mask që e ka sistemin e ngjajshëm për pordorim te ajërit nga ambienti pa pasur nevoj qe ta aktivizoj aparatin e frymarrjes. Autoriteti kontraktues ne sqarimet e **dates 18.05.2022** ka sqaruar edhe për peshën e **Cilindrit,** por Autoriteti kontraktues as njëher nuk ka pasur pyetje apo kerkesa për sqarime nga ana e OE-ve, lidhur me **Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P.** Dhe bazuar ne këtë pretendimi juaj se AK ka jepur sqarime per **Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P , nuk qëndron** ***(shih sqarimin e publikuar nga AK me daten 18.05.2022)***

Lidhur me pretendimet se OE i rekomanduar nuk plotëson kriteret e specifikimit teknik ju sqarojm se janë te pa qëndrueshme dhe te pa argumentuara ligjërit dhe profesionalisht nga ana juaj.Po ashtu për sqarimin tuaj dhe të gjith te ineresuarve po ju shpalos katalogut për Maskën te ofruar nga ana e OE te rekomanduar që dëshmon se Maska ka **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes - „P"** si dhe Fotot e mostres e cila dëshmon për **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes – P.**

AK-ja me sqarimin e lartcekur është munduar të shmanget nga sqarimet që i ka dhënë, për shkak se tek sqarimi i dhënë ceket shumë qartë se mund të përdoren edhe sisteme të ngjashme dhe ekuivalente. Pra sqarimi është dhënë për maskën dhe përderisa AK-ja e ka specifikuar qartë se mund të përdoren edhe sisteme të ngjashme dhe ekuivalente është i qartë fakti se ne kemi ofertuar konform sqarimit të dhënë.

AK-ja me çdo kusht po mundohet që të na eliminoj neve nga aktiviteti i prokurimit, duke u shmangur nga sqarimet që e njëjta i ka bërë.
E njëjta në vendimin për refuzim po ashtu e ka cekur se:

Raporti i ekspertit me nr. 408/22 i dates 19.09.2022 lidhur me kerkesen tuaj per rishyqrtim te dates 16.08.2022 ka trajtuar vetem eleminimin e ofetrës tuaj ne aspekt te maskes dy (2) shtresore (mask e cila nuk ka 2 shtresa izolimi) dhe ne as nje pikë apo rrethan nuk është përgjegjur pozitive se maska e ofruar nga ana juaj ka **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes – P** siq është kërkuar ne specifkim teknik dhe kjo dëshmon mëse miri se ju nuk plotësoni kriterin bazë tek maskës.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm, ku me këtë veprim të AK-së shihet edhe një herë tendenca e të njëjtës për të na eliminuar neve duke u shmangur tani edhe nga konstatimet e ekspertit shqyrtues. Në ekspertizën e ekspertit shqyrtues është cekur qartë :

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka eleminuar ofertën e OE anukues si te papërgjegjëshme për shkak të mos plotësimit të specifikimit teknik të dhënë në dosjen e tenderit. Mirëpo oferta e OE ankues ka plotësuar kushtet teknik të kërkuar në specifikim teknik nga AK. Oferta e OE ankues është ofertë e përgjegjëshme për pikat të cilat është eleminuar. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendëreve në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Ka eleminuar ofertën me çmim më të ulët dhe ka rekomanduar për kontratë ofertën e cila ka çmimin më të lartë për **79.756,00 €** se oferta e OE ankues. Pra rezulton që AK nuk ka respektuar edhe nenin 60 të LPP-së.

Tek mendimi i ekspertit shqyrtues është specifikuar qartë **"Oferta e OE ankues është ofertë e përgjegjshme për pikat të cilat është eliminuar"**. Edhe nga ky fakt kuptohet dhe vërtetohet fakti se ne kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme për **pikat** për të cilat jemi eliminuar.
Nga sqarimi i lartcekur kuptohet edhe një herë tendenca e AK-së për të bërë shmangie edhe nga konstatimet e ekspertit shqyrtues të OSHP-së, pasi që e njëjta po e cek se kinse nuk është trajtuar pretendimi në lidhje me sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes.

Duhet cekur faktin se autoriteti kontraktues po përdor standarde të dyfishta në interpretimin e sqarimit, sepse në njërën anë sqarimin e merr për bazë kur është në pyetje OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa kur është në pyetje oferta jonë, bënë shmangie nga sqarimi dhe e interpreton në favor të OE të rekomanduar për kontratë. Pra AK-ja në këtë rast po vepron me dy standarde dhe se po favorizon një OE të caktuar, ndërsa neve po na diskriminon duke mos pranuar ekuivalenca dhe të ngjashme për sistemin e maskës.

Si përfundim ju sqarojmë se maska e ofruar nga kompania jonë është në harmoni të plotë dhe përmbush të gjitha specifikat teknike të Aneksit 1 dhe të sqarimeve shtesë të ofruara me dt. 18.5.2022, të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit dhe këtë e kemi dëshmuar edhe me katalogun e ofruar dhe me mostrat e dorëzuara.

E ritheksojmë se produktin e ofruar ne, në këtë aktivitet të prokurimit AK-ja e ka në përdorim tash e 2 vite dhe se nuk kemi pas asnjë ankesë dhe nuk presim të kemi asnjë ankesë për cilësinë e setit në tërësi dhe maskës në veçanti.

AK-ja në vendimin për refuzim sa i përket pretendimeve tona ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, ka dhënë përgjigjje si në vijim:

> Lidhur me pretendimet se OE i rekomanduar nuk plotëson kriteret e specifikimit teknik ju sqarojm se janë te pa qëndrueshme dhe te pa argumentuara ligjërit dhe profesionalisht nga ana juaj.Po ashtu për sqarimin tuaj dhe të gjith te ineresuarve po ju shpalos katalogut për Maskën te ofruar nga ana e OE te rekomanduar që dëshmon se Maska ka **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes - „P"** si dhe Fotot e mostres e cila dëshmon për **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes – P.**

AK-ja duke mos mundur ti kundërshtoj pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë e cek se pretendimet tona janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara ligjërisht dhe profesionalisht nga ana juaj. E njëjta e cek se kinse pretendimet tona janë të pa argumentuara, mirëpo nuk e jep asnjë përgjigje në ato pretendime edhe pse ne e kemi sqaruar qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe maska e ofruar nga i njëjti nuk është konform specifikave teknike.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së ti analizojnë në tërësi pretendimet tona ankimore, njëkohësisht duke u bazuar në specifikimet teknike dhe sqarimin e dt.15.05.2022, pasi që në këtë aktivitet të prokurimit po diskriminohemi ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë ndërsa po favorizohet OE i rekomanduar për kontratë i cili është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu nuk jemi shpallur fitues ne, duke vepruar në kundërshtim të plotë me këto dispozita ligjore.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi OE i përgjegjshëm dhe më i lirë se sa OE i rekomanduar **për kontratë në vlerë prej 79.756,00 eurove.**

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Autoriteti kontraktues, përveç se ka marr vendim me të cilin e rrezikon dëmtimin buxhetit në vlerë 79.756,00 euro, nuk e ka respektuar edhe vendimin e OSHP-së duke rrezikuar që të gjobitet edhe nga OSHP-ja e që do të thotë ka rrezikuar edhe më shumë dëmtimin e buxhetit të institucionit përkatës sepse në këto raste gjobat janë të përcaktuara jo më pak se pesë mijë euro, e që nënkupton se mund të gjobitet edhe me 20, 30 apo 50 mijë euro apo më shumë se kaq. Pra ka rrezikuar dëmtimin e buxhetit në dy drejtime dhe me një veprim të AK-së.

Për më tepër mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së përbën shkelje të rëndë, e përcaktuar me nenin 6 paragrafi 6 të Rregullores 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatës profesionale të prokurimit publik, prandaj me këtë veprim të AK-së kuptohet që menaxherit të prokurimit të AK-së duhet ti revokohet licenca e prokurimit publik.

Kërkojmë nga OSHP që të lëshoj urdhëresë për respektimin e vendimit të PSH nr.408/22 të dt.03.11.2022 dhe kërkojmë që ti revokohet licenca prokurimit publik menaxherit të prokurimit, për shkak të shkeljeve të rregullores 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatës profesionale të prokurimit publik.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE "**Fitim R. Bilalli BI**" si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,** **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*